



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 27/15 Prot

Vlorë, më 21.12.2021.

VENDIM

Nr.6, datë 09.12.2021

PËR

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR PËR NDËRTIMIN, RINDËRTIMIN APO SHEMBJEN PËR MBROJTJEN E BRIGJEVE, MUREVE, PRITAVE E VEPRAVE TË TJERA NË BRIGJE TË BASHKISË VLORË, ME VENDNDODHJE FSHATI FITORE, BASHKIA VLORË, QARKU VLORË**



Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Vjosë.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Vlorë, “Për përdorimin e burimit ujqor për ndërtimin, rindërtimin apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave e veprave të tjera në brigje” me vendndodhje Fshati Fitore, Bashkia Vlorë, Qarku Vlorë.
2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

Emri i trupit ujqor: Lumi Vjosë

Koordinatat e vendodhjes së trupit ujqorë (KRGJSH)

X=453873.740; Y=4500084.547;

X=453876.360; Y=4500131.867;

X=454134.338; Y=4499991.657;

X=454398.098; Y=4499972.897;

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI**  
**FLAMUR MAMAJ**  
  
